



Pranimi / Dostizanje Pratimje / Postizanje Received / Delivery	19. 01	2022	2	viti god. Year
Llogaritja / Raporti Organizimit / Org. Unit	In Proti Prot. No.	Shtesa Protig Appendix	Sasia Kopjuna Quantity	
SKPM/SHOK	247/2022		115	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1204/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit numër A.nr.1050/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 17.11.2021, të pranuar me datë 21.12.2021, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.67/2020 të datës 04.03.2020 të parashtruar nga ankuesi përfaqësuar nga Avokati

Komuna e Prishtinës, kundër

Vendimit të datës 04.02.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 19.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.67/2020 e datës 04.03.2020 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës i datës 04.02.2020.
- III. SHFUQIZOHET Vendimi i datës 04.12.2019 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Prishtinës i protokolluar me numër:14-116/ 01-295987/19.
- IV. SHFUQIZOHET Vendimi me numër 14-112/02-20885/20 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës i datës 27.01.2020.
- V. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Prishtinës që ankuesin ta kthejë në vendin e tij të punës, sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2017 me numër 01 nr.112-399 me të gjitha të drejtat dhe detyrat që burojnë nga marrëdhënia e tij e punës.

VI. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Prishtinës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj, ankuesit sipas akt emërimit të datës 01.02.2017 me numër 01 nr.112-399 i sistemuar në vendin e punës "Administrator i TI-së për bazën e të dhënave" në Drejtorinë e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, me datë 04.11.2019 është kërkuar nga Drejtori i Urbanizimit inicimi i procedurës disiplinore me supozimin se i njëjti ka kryer shkelje disiplinore.

Udhëheqësja e Drejtpërdrejtë me datë 05.11.2018 ka përgatitur raportin për inicimin e procedurës disiplinore për shkeljen e supozuar, ndërsa Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës me datë 04.12.2019 ka nxjerr vendimin numër:14-116/ 01-295987/19 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim gradimi deri në pesë (5) vjet".

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 04.12.2021 me numër 14-116/ 01-295987/19, ka parashtruar ankesën me datë 06.01.2020 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me datë 04.02.2020 ka nxjerr vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit ndërsa vendimin e Komisionit Disiplinor e ka lënë në fuqi.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës, me datë 04.03.2020 parashtron ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 574/2020 me pretendimet ankimore se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave ka shkelur dispozita e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores nr.04/2011 për Procedurën Disiplinore të Shërbyesve Civil dhe Rregullores Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil pasi që ka vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendjen faktike ndërsa zbatuar gabimisht ligjin material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit me datë 11.03.2020 e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës. Komuna e Prishtinës më datë 12.01.2022 nëpërmjet e-maili ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 14.05.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 17.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1050/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 14.05.2020 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 04.03.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit e datës 04.03.2020 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 14-070/01-22319/20 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës datës 06.01.2020; Akt emërimit e datës 01.02.2017; Njoftimin e datës 06.11.2019; Raporti për inicimin e procedurës disiplinore të datës 05.11.2019 me detajet e shkeljes së supozuar; E-mailin e datës 04.11.2019 dërguar nga [] me kërkesën për inicim të procedurës disiplinore; E-mailin e datës 04.11.2019 dërguar nga ankuesi për [] me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; Vendimin e datës 04.12.2019 të Komisionit Disiplinor i Komunës së Prishtinës i protokolluar me numër:14-116/ 01-295987/19; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës i datës 27.01.2020; Vendimin e korigjimit të datës 28.01.2020; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 06.01.2020; Akt emërimit e ankuesit të datës 27.01.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.03.2020; E-mailin e datës 30.12.2021 me kërkesën e përsëritur për prova shtesë; Përgjigjen në kërkesë të datës 12.01.2022 me provat e bashkangjitura; Akt emërimit e datës 08.03.2013; Fletëthirrja e datës 02.12.2019 për [] Fletëthirrja e datës 02.12.2019 për z. [] Fletëthirrja e datës 02.12.2019 për z. [] Procesverbalin e datës 02.12.2019 në rastin e dëshmitarit [] Procesverbalin e datës 02.12.2019 në rastin e dëshmisë së ankuesit; Njoftimin e datës 14.05.2020; Aktgjykimin numër A.nr.1050/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 17.11.2021; Autorizimin e datës 29.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [] është, e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Drejtori i Urbanizimit me datë 04.11.2021 nëpërmjet e-maili i është drejtuar U.D Udhëheqëses së Sektorit të Urbanizimit më kërkesën që ndaj ankuesit të iniciohet procedurë disiplinore pasi që i njëjti me datë 01.11.2019 ka përdorur gjuhë fyese ndaj tij. Ndërsa udhëheqësja e drejtpërdrejt e ankuesit me datë 05.11.2019 ka përgatitur raportin për shkeljen e supozuar, kurse Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës me datë 04.12.2019 ka nxjerr vendimin me numër prot: 14-116/ 01-295987/19, me të cilin vendim ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore a "Largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim gradimi deri në pesë (5) vjet".

Me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe në nenin 85 të tij është përcaktuar edhe shfuqizim i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, dhe ka gjetur se i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 11.09.2019 ndërsa ka prodhuar efekte juridike deri me datë 19.11.2019

kur edhe ishte pezualuar së zbatuari nga Gjykata Kushtetuese sipas Vendimit e datës 19.11.2021 për rastin KO203/19, andaj mbi këtë bazë kolegji konstaton se në rastin e zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit kanë vlejtur vetëm dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ngase data kur pretendohet se i njëjti e ka kryer shkeljen e rëndë disiplinore ka qenë në fuqi ligji i lartcekur.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore *"Largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim gradimi deri në pesë (5) vjet"* ka vepruar në kundërshtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 ku përcaktohet se: *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"* pasi që si e tillë masa e shqiptuar disiplinore nuk parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, andaj mbi këtë bazë Komisioni Disiplinor ka vepruar në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 ku përcaktohet: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është në kundërshtim me ligjin material"* dhe si i tillë vendimi me numër prot: 14-116/ 01-295987/19 i Komisionit Disiplinor i datës 04.12.2021 është i kundërligjshëm dhe i njëjti nuk prodhon asnjë efekt juridik ndërsa konsiderohen edhe vendimet e tjera si të kundërligjshme të cilat janë nxjerr me qëllim të zbatimit të vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 04.12.2019, siç është edhe rasti i Vendimit me numër 14-112/02-20885/20 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës i datës 27.01.2020, andaj si të tilla janë shfuqizuar me qëllim të kthimit të ligjshmërisë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka gjetur se ankuesi kundër vendimit të datës 04.12.2019 të Komisionit Disiplinor, me datë 06.01.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 04.02.2020 ka nxjerrë vendimin me të cilin e ka e refuzuar ankesën e ankuesit të datës 06.01.2020, andaj mbi këtë bazë Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave vendimin e datës 04.02.2020 e ka nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ku përcaktohet se: *"Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: "bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret"* pasi që në këtë rast Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka arritur të arsyetojë dhe vërtetojë drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike me rastin kur e ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 04.12.2019 i cili iu është referuar dispozitave ligjore të cilat nuk kanë të aplikueshme në rastin konkret, andaj mbi këtë bazë vendimi i datës 04.02.2020 i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është i kundërligjshëm siç përcaktohet edhe me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative"* dhe si i tillë është shfuqizuar.

Me qëllim të kthimit të ligjshmërisë në rastin konkret, Kolegji thekson faktin se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës obligohet ta shuaj masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankuesit siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 2 të Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Deklarimi*

i shuarjes bëhet sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë, me vendim të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit. Masa fshihet nga dosja e personelit dhe nga regjistri përkatës”.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”,* dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.1204/2021

Flakron Gashi


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit ta ankuesit, Avokatit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

